

VENDIM
Nr. 32, datë 28.2.2019

**MBI MIRATIMIN E “PROPOZIMIT TË TË GJITHË OST-VE PËR NJË
METODOLOGJI PËR KOORDINIMIN E ANALIZAVE TË SIGURISË SË OPERIMIT
NË PËRPTHJE ME NENIN 75 TË RREGULLORES SË KOMISIONIT TË
BASHKIMIT EVROPIAN (BE) 2017/1485, TË DATËS 2 GUSHT 2017, QË PËRCAKTON
NJË UDHËZUES MBI OPERIMIN E SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 7, nenit 16, nenit 53 dhe nenit 63, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, nenit 75 të “Rregullores së Komisionit (BE) 2017/1485”, të datës 2 gusht 2017, të nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin të Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 28.2.2019, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike, për miratimin e propozimit të të gjitha OST-ve për një metodologji për koordinimin e analizave të sigurisë së operimit në përputhje me nenin 75, të “Rregullores së Komisionit të Bashkimit Evropian (BE) 2017/1485”, të datës 2 gusht 2017, që përcakton një udhëzues mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Shoqëria “OST” sh.a., me shkresën nr. 7997 prot., datë 20.11.2018, ka përcjellë në ERE për miratim “Propozimet e të gjithë OST-ve për një metodologji për koordinimin e analizave të sigurisë së operimit në përputhje me nenin 75, të “Rregullores së Komisionit të Bashkimit Evropian (BE) 2017/1485” të datës 2 gusht 2017, që përcakton një udhëzues mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”.

- ERE, me vendimin e Bordit nr. 253, datë 11.12.2018, filloi procedurën për miratimin e “Propozimeve të të gjithë OST-ve për një metodologji për koordinimin e analizave të sigurisë së operimit në përputhje me nenin 75, të “Rregullores së Komisionit të Bashkimit Evropian (BE) 2017/1485” të datës 2 gusht 2017, që përcakton një udhëzues mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”.

- ERE, në vijim të kësaj vendimmarrje dhe në zbatim të nenit 26, pikat 3 dhe 5, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin të Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, me shkresën nr. 30/2 prot., datë 6.2.2019, publikoi në median e shkruar njoftimin për fillimin e kësaj procedure dhe me shkresën nr. 35/2 prot., datë 28.1.2019, ka njoftuar këtë vendim pranë palëve të interesit, nga ku rezultoi që nuk kishte ndonjë koment apo opinion nga palët e interesuara.

- Kjo vendimmarrje është në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, përkatësisht nenit 56 dhe nenit 63, si dhe në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në “Kodin e Transmetimit”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 186, datë 10.11.2017, përkatësisht neni 68 të “Metodologjisë për Koordinimin e Analizave të Sigurisë”.

- Propozimet e të gjithë OST-ve për një metodologji për koordinimin e analizave të sigurisë së operimit, janë në përputhje me nenin 75 të “Rregullores së Komisionit të Bashkimit Evropian (BE) 2017/1485”, të datës 2 gusht 2017, që përcakton një udhëzues mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”, si dhe dokumentin mbështetës mbi mënyrën e zbatimit të këtij propozimi, të përkthyer në shqip nga “OST” sh.a.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të miratojë “Propozimet e të gjithë OST-ve për një metodologji për koordinimin e analizave të sigurisë së operimit në përputhje me nenin 75 të ‘Rregullores së Komisionit të Bashkimit Evropian (BE) 2017/1485’, të datës 2 gusht 2017, që përcakton një udhëzues mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”.

2. Versioni në gjuhën e origjinës (anglisht), ka përparësi në rast mosdakordësie nga palët në interpretim të versionit shqip.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT
Erjola Sadushi